



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 744/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit H.D , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.355/16 të dt.23.8.2016, për shkak të veprës penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 7 lidhur me par 1 të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit H. D dhe të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari me dt.21.9.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri H. D i lindur me dt.16.6.1964, në fsh. ---- Komuna e Klinës ,tani me vendbanim në ---- rruga -----pa nr. i biri i H dhe nënës Gj e gjinisë G, , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 30.1.2016, rreth orës 20:20 , në rrugën Zahir Pajaziti , Komuna e Pejës, tek ETC-ja ,nga pakujdesia ka shkelur ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor nga neni 54 pika 1, në atë mënyrë që i pandehuri ka qenë duke qarkulluar me automjetin e llojit D-Chrysler, ngjyrë të kaltër –verdhe, me targa të regjistrimit -----, duke mos ju përshtatur kushteve të rrugës -shpejtësisë i njëjti hynë në tejkalim në mënyrë të pasigurt duke mos e siguruar një veprim të tillë dhe gjatë tejkalimit për ta kaluar automjetin e llojit Mercedes 200D, të cilën e drejtonte i dëmtuarit A. H i cili ishte në të njëjtën krosi të rrugës , me ç’ rast i njëjti kthehet në të majtë në drejtim të qendrës tregtare ETC , ku i pandehuri me pjesën e parë të anës së djathtë e godet derën e parë të automjetin e të dëmtuarit në pjesën e majtë dhe nga goditja që ka pësuar i pandehuri me automjetin e tij kishte bartur të dëmtuarin në distancë prej 20 metra, dhe përsëri i pandehuri kishte goditur me pjesën e djathtë veturën e llojit VW Golf, pronë e të dëmtuarit G. A e cika në ato momente ka qenë e parkuar në anën e majtë jashtë rrugë , ku si pasojë janë shkaktuar dëme materiale dhe lëndime të lehta trupore kanë pësuar të dëmtuarit A. H dhe G.A.

-me çka ka kryer vepra penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 7 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 378 7 lidhur me par 1 të KPRK-së. I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

I pandehuri për shkak të gjendje së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësorë dhe të shpenzimeve të procedurës penale.

Të dëmtuarit për realizimin eventual të kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.23.8.2016 kundër të pandehurit H.D , ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.355/16, për vepre penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 7 lidhur me par 1 të KPRK-së , duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme gjendjen jo të mirë ekonomike , faktin se i pandehuri është majtës i familjes prej 5 anëtarësh , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPRK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.21.9.2017

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .